

QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara



**ÇFARË ËSHTË AUTIZMI DHE
NË ÇFARË MËNYRE MUND
T'JU JAPIM MBËSHTETJE
FËMIJËVE ME AUTIZËM**

ÇFARË ËSHTË AUTIZMI?

Autizmi është një çrregullim zhvillimor që shpesh paraqitet gjatë tre viteve të para të jetës së fëmijës. Arritja e diagnozës së autizmit aspak nuk është e lehtë, sepse nuk ka metoda të thjeshta me të cilat mundet me siguri të thuhet që ndonjë fëmijë ka çrregullime me shenja autizmi. Diagnoza bazohet në vërejtjen e disa formave të caktuara të sjelljes së fëmijës.

Arsyet e paraqitjes së autizmit nuk janë të njohura saktë dhe ka shumë teori për këtë dukuri.



Autizmi paraqitet në 1 prej 59 fëmijëve, më shpesh tek djemtë sesa tek vajzat, në çdo rrethinë dhe pavarësisht nga përkatësia kombëtare ose etnike, pavarësisht nga statusi ekonomik dhe social, me gjasa më të mëdha tek raca e bardhë sesa tek racat tjera.

Me zbulimin e hershëm dhe trajtimin e duhur, vështirësitë që kanë fëmijët me autizëm mund të zvogëlohen, por sërish do të jenë të pranishme në një masë, varësisht nga kufizimi i tyre, çdoherë do të kenë nevojë për ndonjë formë të mbështetjes.

Diagnoza e hershme, trajtimi dhe përfshirja në procesin arsimor janë kyçe për avancimin e shkathtësive sociale dhe ato të komunikimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet pavarësi më e madhe dhe jetë e plotë dhe produktive.

VEÇORI TË FËMIJËVE ME AUTIZËM

Fëmijët me autizëm kanë vështirësi në tre fusha kryesore, ndonëse manifestimi dhe shkalla e shprehjes së veçorive janë të ndryshme tek secili fëmijë.

Vështirësi sociale:

- Pak ose aspak nuk ka kontakt me sytë;
- Nuk reagon në buzëqeshje ose shprehje tjetër të fytyrës së prindërve;
- Nuk e ndjek gjënë që i thonë prindërit;
- Nuk tregon me gisht drejt gjërave që dëshiron t'i shikojë;
- Nuk i merr lodrat t'ua tregojë prindërve;
- Shpesh nuk ka shprehje të caktuar në fytyrë (urrejtje, lumturi);
- Ka vështirësi në kuptimin e ndjenjave të njerëzve të tjerë;
- Nuk tregon ndjenja ndaj tjerëve;



- Vështirë krijon shoqëri ose nuk duket i interesuar për shoqërim;
- Nuk përfshihet në lojë me bashkëmoshatarët;


Vështirësi komunikimi

- Nuk tregon me gisht drejt gjërave që t'i kërkojë;
- Nuk flet asnjë fjalë deri në moshën prej 16 muajsh;
- Përsërit fjalë ose fjali pa mos kuptuar domethënien (eholali);
- Nuk reagon kur dikush ia thërret emrin, por reagon në zëra tjerë;
- E përziën përdorimin e UNË dhe TI; Për veten flet me TI, ndërsa tjerëve ju drejtohet me UNË;
- Shpesh duket sikur nuk dëshiron të komunikojë;
- Nuk i përdor lodrat për të imituar njerëzit në jetën e përditshme (gjegjësisht, nuk luan role);
- Mund të përsërit shumë mirë numra, shkronja ose reklame në TV;
- Mund të paraqitet mungesë e plotë e të folurit (në moshën mes 15 dhe 24 muaj) ose të ndonjë aftësie tjetër të përfituar.

Sjellje të përsëritura

- Shpeshherë luajnë me pjesë të lodrës sesa me gjithë lodrën (për shembull, luajnë me rrotullat, dhe jo me gjithë makinën);
- Rrotullohet, lëkundet, ecën gjatë në gish-ta, troket ose lëviz dorën (përsërit lëvizje të caktuar që nuk kanë qëllim ose pa asnjë arsye);
- Do rend dhe rituale dhe orar të caktuar. Nuk do ndryshime dhe reagon me shqetësim të lartë dhe qarje;

- Mund të jetë tepër i ndjeshëm ose aspak i ndjeshëm ndaj zërave, dritës, teksturave ose prekjes;
- Shpeshherë flet për tema të njëjta ose luan me gjëra të ngjashme në mënyrë të njëjtë;
- Shumë fëmijë me autizëm kanë lëvizje të pazakontë të trupit dhe kanë ecje të padrejta (ecin në gisht dhe me pjesën e epërme të këmbës);
- Duket sikur nuk ndjejnë dhimbje.
- Nuk ekzistojnë dy fëmijë identik me autizëm



Të mësuarit tek fëmijët me autizëm

Fëmijët me autizëm kanë vështirësi në të mësuarit, andaj duhet që programi t'u **përshtatet ndaj shkathtësive të tyre që të arrijnë përparim më të madh.**

Me rëndësi është të zbulohen anët e dobëta dhe të fuqishme **të fëmijës, çfarë është ajo që e motivon dhe** e mahnit, dhe çfarë është ajo që e shqetëson.

MESAZHE NGA PRINDËRIT

1. **Autizmi nuk është sëmundje mendore.**
2. **Fëmijët me autizëm gjithashtu dëshirojnë të shoqërohen sikur fëmijët e tjerë.** Ndoshta flet ndryshe, ose i bënë gjërat në mënyrë të ndryshme, por ajo është pjesë e tij/saj. Mund të jetë interesant, kokëfortë, i lumtur.
3. **Mos flitni për fëmijën me autizëm në vetën e tretë kur është i/e pranishëm/me në bisedë.**
4. **Fëmijët me autizëm kanë nevojë për shumë durim dhe kuptim.** Ato nuk janë fëmijë të paedukuar. Ndonjëherë ajo është mënyra e vetme në të cilën komunikojnë. Vetëm paramendoni nëse nuk mund të shprehni atë që ju mundon ose që doni? Vështirë është, apo?
5. **Autizmi nuk është pasojë e prindërve të ftohtë dhe pa interes që nuk ju kushtojnë vëmendje të rëndësishme fëmijës së tyre.** Silluni ndaj fëmijëve tanë dhe familjeve tona me respekt dhe dinjitet.
6. **Fëmijët tanë kanë ndjenja.** Nëse nuk mund të flet në mënyrë të njëjtë sikur ju, nuk do të thotë që nuk ka emocione.
7. **Secili fëmijë me autizëm është i ndryshëm.** Mos nënvlerësoni fëmijën tim për shkak të diçkaje që e keni lexuar ose mësuar për autizmin.
8. **Mos keni keqardhje për ne si familje ose si prindër.** Ne jemi familje ngjashëm sikur gjithë të tjerët. Jeta jonë, si dhe e juaja, përbëhet nga sfida, suksese dhe rrëzime.

Përparimi i fëmijëve me autizëm varet nga cilësia dhe sasia e mbështetjes që kanë fituar, por edhe nga aftësitë e tyre.

Komunikimi

- Përdorni stile të ndryshme komunikimi (me shkrim, verbal, gjeste, komike, vizuale dhe pasqyra).
- Përdorni gjuhë të thjeshtë dhe të saktë kur jepni udhëzime; filloni me një fjalë dhe vazhdimisht lëvizni drejt fjalive më të ndërlikuara.
- Tregoni gjërat në mënyrë pozitive, duke filluar me atë që dëshironi, dhe jo vetëm atë që nuk dëshironi të bëhet.
- Mundohuni që aktivitetet të jenë në renditje të drejtë dhe ndiqni renditjen ditore.


Trajtime

Nuk ka vetëm një trajtim për autizëm, andaj shpesh ka nevojë për kombinim të shpeshtë varësisht nga vështirësitë, mosha, ngadalësimi në zhvillim dhe nevojat e fëmijës dhe familjes.



Hulumtimet tregojnë që për efekt maksimal duhen rreth 25-40 orë në javë punë me fëmijën (me logoped, defektolog, psikolog, mësime-dhënës, prindër dhe gjithë familjen).

Rezultatet më të mira arrihen nëpërmjet të ashtuquajturave trajtime biheviore: logoped, defektolog, integrim sensorë, terapi me anë të lojës, terapi me punë, ABA terapi, etj.



Tek disa fëmijë mund të ndihmojnë edhe terapia me not (Halliwick metoda), hipoterapia (kalërimi), terapia me muzikë dhe të tjera.

Rrethina sociale

- Mësoni sjelljet sociale fëmijëve me anë të "luajtjes së roleve" dhe demonstrimeve praktike të situatave të ndryshme.
- Kini reagime të qarta dhe vijuese nëse sillen në mënyrë të padrejtë në ndonjë situatë.
- Inkurajoni në mënyrë të drejtë shprehjen e ndjenjave me anë të përdorimit të fjalëve, dhe nëse nuk flasin, përdorni figura të emocioneve të ndryshme, duke vendosur theks në shprehjen e fytyrës, pozitën e pjesëve të fytyrës, syve, vetullave, gojës...) që nëpërmjet figurës të tregojnë mënyrën si ndjehen.

Organizimi i rrethinës

Fëmijët me autizëm mund të jenë konfuz kur ju ndryshohet renditja. Ata mund të dinë se çfarë pritet në një situatë, por nuk mund të transmetojnë atë njohuri në situatë tjetër të ngjashme. Në vijim janë paraqitur disa hapa që mund të ndërmerim:

- Në mënyrë të qartë sqaroni rregullat që kanë të bëjnë me secilën situatë që do të paraqitet.

- Ushtroni shkathtësi të njëjta në situata të ndryshme.
- Përdorni një sinjal të qartë me të cilin shënohet fillimi dhe fundi i aktivitetit.
- Përdorni fjalë të thjeshta për të paralajmëruar çdo ndryshim të aktiviteteve.

Çfarë mund të shqetësojë fëmijët me autizëm

- Zhurma në rrethinë
- Mund të jenë të ndjeshëm ndaj materialeve të ndryshme, etiketave, veshmbathjeve
- Janë më të ndjeshëm ndaj shijeve të ëmbla/tharta
- Mund të shqetësohen nga llojet e ndryshme të aromave
- Rrezet e dritës mund të ndjehen sikur reflektim i fuqishëm
- Hapësira e re dhe e panjohur
- Ndryshime ose përjashtime nga rrjedhja e zakonshme e aktiviteteve
- Ndërpritje të aktiviteteve që fëmija vetëm më ka filluar t'i bëjë





Në çfarë mënyrë të sillemi kur fëmija me autizëm është i shqetësuar?

- ✓ Përqafoni fëmijën.
- ✓ Drejtoni vëmendjen e fëmijës ndaj ndonjë gjëje ose aktiviteteve të tjera.
- ✓ Qëndroni të qetë kur fëmija juaj është i shqetësuar.
- ✓ Mos korrigjoni sjelljen e fëmijës në prani të tjerëve.
- ✓ Mundohuni të përdorni më pak të folur, ndërsa më tepër udhëzime vizuale.
- ✓ Hapësira e qetë mund të ndikojë pozitivisht mbi shqetësimin e fëmijës.
- ✓ Jepni kohë fëmijës që të qetësohet.
- ✓ Pasi të qetësohet, bashkërisht shikoni situatën që e ka shqetësuar.

MITE DHE FAKTE



- ❖ Shpeshherë për personat me autizëm thuhet që jetojnë në botën e tyre. **Kjo nuk është e vërtetë! Ata vetëm përjetojnë botën në mënyrë të ndryshme.**
- ❖ Personat me autizëm janë të pamotivuar dhe të ftohtë, pa ndjenja. **Kjo nuk është e vërtetë! Shpeshherë ata janë tepër emocional. Ndaj më të afërmve tregojnë shumë emocione.**
- ❖ Personat me autizëm janë agresiv. **Kjo nuk është e vërtetë! Ata nuk janë më agresiv se ndonjë person mesatar.**
- ❖ Të gjithë personat me autizëm janë me ndonjë lloj pengese intelektuale. **Kjo gjithsesi nuk është e vërtetë!** Njerëzit ende mendojnë që nëse fëmija me autizëm nuk flet, automatikisht ka edhe pengesa intelektuale. Madje edhe në qarqet shkencore përmendet numri mes 70 dhe 80 përqind, por kjo duhet të merret me rezervë për shkak të metodave me të cilat bëhet vlerësimi. Në fakt, sipas in-

formacioneve nga prindërit, fëmijët me autizëm nuk kanë interes ose durim të mbarojnë testet e inteligjencës, por ajo nuk do të thotë se kanë pengesa intelektuale.

- ❖ Personat me autizëm janë ngarkesë e familjeve dhe shoqërisë. **Kjo nuk është e vërtetë!** Ata që punojnë me personat me autizëm thonë që mund të jenë punëtorë mjaft të mirë që në mënyrë të dedikuar dhe të vlefshme i kryejnë detyrat e tyre.
- ❖ Të gjithë fëmijët me autizëm janë gjeni. Kjo gjithashtu nuk është e vërtetë! Ngjashëm me të tjerët, ashtu edhe tek personat me autizëm vetëm 5-10 përqind kanë "aftësi mbi-mesatare për mësim", siç janë shembujt me shkathtësitë mbi-mesatare matematikore, aftësi që të luajnë ndonjë melodi në mendje



pas një dëgjimi ose të vizatojnë ndonjë ndërtesë, në mënyrë të detajuar dhe saktë, pasi të kenë parë.

- ❖ Autizmi është pasojë e prindërimit të dobët. **Kjo gjithsesi nuk është e vërtetë!** Kjo teori kontroverse është vazhduar me teorinë për "nënë e ftohtë", sipas së cilës fëmijët bëhen autik sepse nënat janë të ftohtë në



mënyrë emocionale, gjegjësisht nuk ju tregojnë mjaft dashuri dhe vëmendje dhe nuk vendosin lidhje emocionale me ata.

- ❖ Autizmi është një lloj ekscentrizmi – shumë persona me autizëm janë ekscentrik, por edhe shumë kreativ dhe plotë me ide origjinale. Megjithatë, tek personat me autizëm kjo nuk është zgjedhur me qëllim si

stil i jetës, por si rezultat i asaj që kanë shikim të ndryshëm të botës, andaj kur prindërit mundohen të mësojnë shkathësi të caktuara të jetës, ata ndjehen sikur të jenë nën shtypje të madhe. Autizmi ka një spektër të gjerë të veçorive, ndërsa aspekti ekscentrik mund por edhe nuk duhet patjetër të jetë i pranishëm tek të gjithë personat.

- ❖ Fëmijët me autizëm nuk ndejnë empati ose lidhje emocionale - e vërtetë është që disa fëmijë dhe persona me autizëm kanë vështirësi të lidhen me persona të tjerë, por kjo nuk do të thotë që nuk ndejnë empati. Shumë prindër do të konfirmojnë që fëmijët e tyre kanë spektër të njëjtë të emocioneve sikur të tjerët – frikë, lumturi, nervozë, kënaqësi. E njëjta vlen edhe për empatinë. Shumë prej tyre e ndejnë pikëllimin dhe shqetësimin tuaj andaj do të ju përqafojnë.
- ❖ Ka shumë trajtime me të cilat autizmi mund të shërohet – ka shumë trajtime dhe terapi me të cilat mund të arrihet përparim i madh tek fëmijët me autizëm, por nuk ka ndonjë bar konkret. Disa terapi ju ndihmojnë disa fëmijëve, por tek tjerët nuk kanë ndikim, që domethënë se qasja është individuale dhe varet prej shumë faktorëve. E njëjta vlen edhe për terapinë me barnat.
- ❖ Shkenca e di se çfarë e shkakton autizmin. Vazhdimisht prezantohen studime të reja që kontribuojnë për kuptimin e kësaj gjendjeje por shkakut i saktë ende nuk është i njohur.



Dhe në fund, gjithçka ka të bëj me dy fjalë: dashuri dhe shumë durim.

Ndoshta nuk jam i shkathët në vendosjen e kontaktit me sy dhe bashkëbisedim, por e dini se jam i singertë, nuk i gjykoj njerëzit, nuk gënjej kur luaj letra me të tjerët.

Bëhuni shokë të mi, përkrahja ime dhe do shihni sesa mund të arrij.

Fëmijë me autizëm



QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara

QENDRA E RESURSEVE

rr. Vasko Karangeleski 33

1000 Shkup

++389 78 449 851

++389 78 449 852

www.resursencentar.mk

Hartimi i broshurës është mundësuar me mbështetjen financiare e UNICEF-it, në kuadër të projektit: "Rritja e Mundësive për Inkluzion dhe Përmirësimi i Cilësisë së Jetës së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara me anë të Fuqizimit të Prindërve dhe Familjeve të Tyre".

unicef 

Qëndrimet e shprehura në këtë broshurë janë vetëm të autorëve dhe nuk duhet patjetër të përputhen me qëndrimet dhe politikat e UNICEF-it.